

Klubi i Artit & Kulturës



2014 - 2015



Të dashur miq e dashamirës të Artit dhe Kulturës,

Dëshirojmë të ndajmë me ju disa nga momentet dhe aktivitetet e organizuara nga “Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA” përgjatë dy viteve të fundit.

Të rinj, shkrimtarë, poetë, muzikantë, piktorë, skulptorë, artistë të mëdhenj e me përvojë dhjetëra-vjeçare kanë qenë pjesë e aktiviteteve tona që nga viti i themelimit të Klubit të Artit, e padyshim kanë pasur gjithë mbështetjen tonë edhe përgjatë viteve 2014 dhe 2015.

Të bindur që Shqipëria mbart vlera të mëdha, talente të rralla e artistë unikë, ne do të jemi gjithmonë pranë tyre për t’u ofruar mbështetje morale, profesionale dhe financiare, e mbi të gjitha sigurinë drejt së ardhmes.

Veprimtaritë kulturore, artistike të Klubit të Artit e Kulturës, SIGAL

Durrës, Janar 2014 – Dhjetor 2015



Albania

SIGAL Business Center

Biv: "Zogu I", Nr. 1, Tirana, Albania

Tel: (+355) 4 2233 308, Fax: (+355) 4 2250 220

e-mail: info@sigal.com.al, www.sigal.com.al



Kosova

Rr. "Vaso Pasha", p.n. Pejton, 10 000,

Pristine, Kosova

Tel: (+381) 38 240 241, Fax: (+381) 38 240 241 123

e-mail: info@sigal-ks.com, www.sigal-ks.com



Macedonia

Rr. "Marks & Engels" 3, 1000

Skopje, Macedonia

Tel: (+389) 2 3125 920, Fax: (+389) 2 3215128

e-mail: info@uniqa.mk, www.uniqa.mk

Të dashur miq!

Mbas botimit të librit kushtuar aktiviteteve të “Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA”, Durrës për vitin 2013, kemi kënaqësinë që, të paraqesim për ju edhe librin e ri, ku përmbledhen dhe pasqyrohen aktivitetet e vitit 2014 - 2015. Sigurisht, ky libër vjen mbas një përvoje të vyer nga botimi i mëparshëm. Në këtë botim, nuk janë evidentuar vetëm aktivitete të karakterit profesional apo aktivitete shoqatash të ndryshme, por një gamë shumë më e gjerë aktivitetesth, dhe jo më kot, ne kemi kënaqësinë të pohojmë se:

“Klubi i Artit dhe Kulturës Sigal”, Durrës, nga viti në vit jo vetëm që i ka hapur dyert për të gjitha kategoritë e artistëve, instrumentistë, këngëtarë, por vazhdon të mbetet një mbështetës i sinqertë i tyre. Janë me dhjetëra koncerte recital nga nxënës, artistë të rinj dhe të vjetër që vinë të performojnë çdo vit këtu vlerat e tyre artistike. Ekspozita pikturash dhe të grafikës, promovime librash dhe aktivitete të shumta letrare, tashmë janë bërë pjesë e veprimtarive të përditshme të këtij Klubi. Po ashtu, pranë ambienteve tona të kulturës organizohen një numër i madh konferencash shkencore, simpoziume dhe “ëork shope”. Janë me qindra të rinj artistë dhe veprimtarë që janë familjarizuar tani me morinë e veprimtarive të panumërta që organizohen këtu. Artistë me emër edhe në nivel kombëtar si, pianisti Thanas Paskali, piktori Lonard Voci, karikaturisti Bujar Kapexhiu, dirigjenti Zhani Ciko etj, janë bashkautor me ne. “Klubi i Artit dhe Kulturës” me këtë mori veprimtarish po kontribuon në këtë mënyrë aktivisht edhe në gjallërimin e veprimtarive dhe jetës koncertale në qytet.

Gjithmonë, në kuadrin e këtyre synimeve, Klubi ynë i ka zgjeruar kufijtë e veprimtarive të tij. Ne, tashmë kemi shkuar dhe vazhdojmë të shkojmë edhe në studiot e artistëve dhe poetëve të mirënjohur. Aktiviteti i suksesshëm në studion e artistit të mirënjohur Idriz Balani është mjaft sinjifikativ. Po kështu, takimet e përbashkëta me artistë të huaj kontemporanë dhe vënia e ambienteve të këtij Klubi në dispozicion të tyre, janë prioritetet e përhershme tonat. Mjaft i suksesshëm ka qenë bashkëpunimi ynë edhe me ambasadat e vendeve të huaja, për të sjellë herë pas here këtu poete, shkrimtarë dhe artistë nga vendi i tyre. Përmendim këtu Ambasadën Amerikane, Spanjolle, Austriake, Holandës, Franceze, etj. Klima e ngrohtë që na ka karakterizuar ne si staf, është pasqyruar edhe në shtimin e numrit të aktiviteteve por edhe në cilësinë dhe nivelit të tyre.

Natyrisht të gjitha këto aktivitete kaq të suksesshme, nuk mund të ishin bërë të mundura pa dëshirën e mirë dhe kontributin e vyer të Kompanisë së Sigurimeve “Sigal Uniqica Grup Austria” me drejtor të përgjithshëm Z. Avni Ponari. Salla e Klubit, gjithmonë është dhënë falas në dispozicion të të gjithëve (e vetmja në këtë mënyrë shërbimi), si gjest bujarie dhe kontribut për artin dhe letërsinë.

Të dashur miq! “Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA” ju falënderon për bashkëpunimin dhe ju fton që dhe në të ardhmen të punojmë përsëri së bashku.

Ermir Dizdari, dirigjent

“Mjeshtër i Madh”

Drejtor

i Klubit të Artit dhe të Kulturës, SIGAL UNIQA



Veprimtaritë kulturore artistike
të Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA

Durrës, Janar – Dhjetor 2014

Nr. 1 në tregun e sigurimeve!

SIGURIMET
E MAKINËS

SIGURIMET
E BIZNESIT

PENSION
PRIVAT

SIGURIMET
E SHËNDETIT

SIGURIMET
E JETËS

SIGURIMET
E PRONËS

SHQIPËRI

SIGAL Business Center
Blv. "Zogu I", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: (+355) 4 2233 308
Fax: (+355) 4 2250 220
E-mail: info@sigal.com.al
www.sigal.com.al

KOSOVË

Rr. "Vaso Pasha", p.n. Pejton,
10 000, Prishtinë, Kosovë
Tel: (+381) 38 240 241
Fax: (+381) 38 240 241 123
E-mail: info@sigal-ks.com
www.sigal-ks.com

MAQEDONI

Rr. "Marks & Engels" 3,
1000 Shkup, Maqedoni
Tel: (+389) 2 3125 920
Fax: (+389) 2 3215128
E-mail: info@uniqa.mk
www.uniqa.mk

E martë, datë 14 janar 2014, ora 18:00

Aktivitet: Takim me grupin e të rinjve, pjesë e projektit “Këshillimi drejt punësimit”, financuar dhe mbështetur nga Sëiss Contact.

Qëllimi i këtij projekti është këshillimi i të rrinjëve për punësimin e tyre në përfundim të projektit në tërësi. Në këtë datë u zhvillua takimi i radhës me pjesëmarrësit e grupit, në ambientet e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL. Qëllimi i këtij takimi ishte risjellja në vëmendjen e tyre të elementëve dhe rregullave që duhet të kenë parasush gjatë zhvillimit të një interviste pune, por edhe për mbajtjen e vendit të punës, pasi ta kenë fituar atë. U zhvilluan punë të pavarura në grupe për konkretizimin e këtyre elementëve dhe rregullave me anë të ‘role-play’.

E rëndësishme e takimit ishte edhe atmosfera muzikore e krijuar nga tre pjesëmarrësit e grupit, përmes luajtjes së pjesëve muzikore me instrumentat muzikore si: piano, violinë, oboe.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe koordinatorët e projektit, të cilët dhanë vlerësimet e tyre për punën e bërë me pjesëmarrësit e grupit.

Përgatiti:

Këshilluesja, Amarilda Nokaj



E premte, datë 17 janar 2014, ora 11:00

Në vijim të gjallërimit të jetës letraro-artistike dhe përkrahjen e vlerave të spikatura letrare, Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Klubin Artistik “Epoka e Talentit”, organizuan takimin me shkrimtarë nga të gjitha rrethet e vendit. Kritikë, skulptorë, shkrimtarë, gazetarë dhe poetë u mblodhën këtu për njohjen e vlerave të shkrimtares nga Vlora, znj. Natasha Limaj.

Eventi shqyrtoi rolin e të rinjve në fusha të ndryshme të artit si piktura, muzika e letërsia dhe gërshetimin e këtyre fushave për të krijuar plejadën e të rinjve artistë, njohjen me ta dhe si funksionon arti pamor dhe shkrimor, në prezencë të artistëve të letrave shqipe.

Aktivitetin e udhëhoqi dhe e ideoi

Adriana ISTREFI drejtuese & themeluese e klubit, “Epoka e Talentit” si dhe Mimiza ERBARA , gazetare , shkrimtare dhe kordinatore e klubit.

Pjesëmarrës: Rreth 60 persona



E shtunë, datë 18 janar 2014, ora 11:00

“Zëri 16+...”, si pjesë e projektit “Save the Children”, organizoi një takim për njohjen me projektet e vitit 2014.

Në kuadër të ngritjes së kapacitetit për anëtarët e rinj të klubit, u organizua edhe ëorkshopi me qëllim që fëmijët të mësonin të diskutonin për hartimin dhe zhvillimin e planeve apo ideve të ndryshme për aktivitete. Njohuritë kryesore për të cilat u pajisën fëmijët ishin si të hartojnë një format për planin e aktivitetit.

Pjesëmarrës: Deri 20 persona



E hënë, datë 03 shkurt 2014, ora 18:00

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL, në bashkëpunim me zyrën e marrëdhënieve me publikun të Ambasadës Amerikane në Shqipëri, organizuan mbrëmjen Jaz dhe Blues me pjesëmarrëjen e dy këngëtarëve dhe instrumentistëve të njohura të kësaj rryme në SHBA La Frae Sci, bateriste, kompozitore dhe ambasadore e kulturës me bazë në Neë Jork (e para bateriste femër dhe drejtore në historinë e Brodueit dhe Mazz Sëift violinist.

Pjesëmarrës në mbrëmjen artistike ishin mbi 50 persona, artistë të fushave të ndryshme si dhe dashamirës të muzikës Jazz e Blues.

<p>Ftesë:</p> <p>Z./Znj. _____</p> <p>Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës Amerikane në Shqipëri dhe Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL kanë kënaqësinë tju ftojne në:</p> <p>MBRËMIJEN JAZZ DHE BLUES</p> <p>të artistëve njohurkeze LaFrae Sci - bateri/vokal Mazz Swift - violinë/vokal</p> <p>Ditën e Hënë, datë 03/02/2014, ora 18:00 në ambientet e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL, Durrës</p>	<p>Public Affairs Office & SIGAL Art & Culture Club cordially invites you to an</p> <p>EVENING OF JAZZ AND BLUES</p> <p>Featuring New York artists LaFrae Sci on Drums/vocal Mazz Swift on Violine/vocal</p> <p>Monday, February 3, at 18:00 SIGAL Art & Culture Club, Durrës</p> <p>Program:</p> <p>Oh Freedom Wade in the water Aint gonna let nobody turn me round Space oddity - David Bowie Queen Margaritas Theme - from Master and Margarita meets jazz (composed by LaFrae Sci) Inspired by the novel by Bulgakov. Dark Shadows - Master & Margarita meets jazz Improvisation and blues. Original compositions by Mazz Swift</p>
---	--

The 3th Amendment
Koncert Jazz & Blues

LaFrae Sci
bateri/vokal

Mazz Swift
violinë/vokal

Ditën e Hënë, 03/02/2014



E martë, datë 04 shkurt 2014

Në kuadrin e turneut të tyre në qytetin tonë bateristja dhe vokalistja La Frae Sci dhe violinistja dhe vokalistja Mazz Sëift, organizuan një master class me nxënësit e shkollës artistike “Jan Kukuzeli” në Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA në Durrës. Ata performuan pjesë nga repertori i tyre i zgjedhur si dhe të disa prej artistëve botërorë.

Pjesëmarrës: Deri 60 persona



E premte, datë 07 shkurt 2014, ora 18:00



SIGAL
UNIONA GROUP AUSTRIA

Klubi i Artit & Kulturës

Ftesë

Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
organizon në ambjentet e tij

Koncertin recital të nxënësve
të kursit të pianos dhe violinës
të mësueseve:

Panajota Hoxha – piano,
Mesila Haxholli – piano,
Alketa Nikolla – violinë.

Domë e premte, datë 07/02/2014 . ora 18:00

Koncert recital
Durrës, Shkurt 2014

Programi

Bayer - 2 etyde
Noel Baja (mësuese Panajota Hoxha)

Berger-Pjese dhe The cuckoo,
Loxton -Chenies of Dunkirk,
Mak Donald - pjese me kater dur.
Klara Likaxhiu (mësuese Mesila Haxholli)

Magidenko - "Gjeli i Vogël", pjese per violine
Arta Boci (mësuese Alketa Nikolla)

Moxart - Marshi Turk,
Beth - Per Elizen,
Kenge Ruse (Folk),
Rei Haxhiu (mësuese Panajota Hoxha)

Shtraus - Danubi Blu,
Brams - Valle Hungareze,
Shuman - The Horse,
Ruze - Katiushka
Julia Cenka (mësuese Mesila Haxholli)

Pjeter Gaci - " Valle Festive"
Flori Tivari (mësuese Alketa Nikolla)

Cajkovski - Kenge Italiane & Liqeni i mjejmave,
Bach - Mussete ,
Kristi Tango (mësuese Panajota Hoxha)

Bach - Mussete,
Tish Dalja- Ne piknik,
Xhoriz Beqiraj (mësuese Panajota Hoxha)

J.S Bach - Minuet
Anja Zalla (mësuese Alketa Nikolla)

Moxart - Sinfoni dhe Marshi Turk,
Cajkovski - Valsi i luleve
Plachebel - Canon
Andia Hatellari (mësuese Mesila Haxholli)

Antonio Vivaldi - Sonate Nr 5
Greta Miraka (mësuese Alketa Nikolla)

Klubi i Artit & Kulturës 

Rruga, "Tregtare", Durrës
Cel: 0694068672, 0692148125



Me taentet për talentet sepse ata janë edhe e ardhmja e muzikës sonë instrumentale.

Në këtë kuadër Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL organizoi në ambjentet e tij Koncertin recital të nxënësve të kursit të pianos dhe violinës të mësueseve:

Panajota Hoxha – piano,
Mesila Haxholli – piano,
Alketa Nikolla – violinë.

Pjesëmarrës: Deri 50 persona



E mërkurë, 12 shkurt 2014, ora 18:00

SIGAL
UNICA GROUP AUSTRIA

Klubi i Artit & Kulturës

Ftesë

Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
organizon në ambjentet e tij

Koncertin Instrumental
të nxënësve të shkollës artistike
"Jan Kukuzeli"

Pergatitur nga mesuesit:
Klara Noçka, violinë
Besmir Veshti, piano

Ditën e mërkurë, datë 12/02/2014 , ora 18:00

Koncert Instrumental
Durrës, Shkurt 2014

Program:

Nekrasov - "Gjeli i vogel"
Flona Mustafaraj

Nekrasov - "Top - top"
Klaudja Giloga

Mozart - "Allegretto"
Megan Nuredini

Paganini - Kapricio
Mozart - "Marchi turk"
Drisi Ziri

Harapi - Prelud
Duncombe - Sonatine
Athina Esli

Dvariona - Prelud
Duncombe - Sonatine
Blerina Qyrbja

Veher - Vals
Noemi Behari

Gedik - Allegro
Ylika Hyseni

Bach - Minuet
Matteo Shehi

Riding - Koncert Si - koha III
Pamela Giloga

Gedik - Sonatine
Fabien Taraj

Vivaldi - Sonata nr.8
Klejd Lila

Shopen - Vals
Armando Boçi

Mozart - Sonatë
Klejd Hodo

Hajden - Koncert sol + koha I
Ester Hoxha

Shopen - Vals
Enea Kondo

Klubi i Artit & Kulturës **SIGAL**

Rruga, "Tregtare", Durrës
Cel: 0694068672, 0692148125




E enjte, datë 13 shkurt 2014 ora 18:00

Koncert instrumental i nxënësve të shkollës artistike “Jan Kukuzeli, nën drejtimin e mësueses së pianos, Katerina Kume.

Nxënësit pjesëmarrës:

Dea Zalla - Pjesë të vogla nga Genesina

Greis Hoxha - Pjesë të vogla nga Genesina

Kristel Karagozi – Dy valse nga Schmitt & Moxar

Arta Sallaku –Pjesë nga Moxart & Beethoven

Sibora Agasi – Pjesë nga Schuman, Klementi & Chaplin

Endi Shani – Sonatine nga Kulau & Vals Sentimental nga Cajkovski

Klei Prifti – Pjesë nga Novacek (shoqëron në piano, mësuese Mirela Xhaferaj)

Arjela Hushi – Sonatine nga Dussek & Pjesë ruse nga Kalinikov

Bora Stroka – Sonate nga Skarlatti & Temë me variacione nga T. Harpi

Myrgen Xhaferaj –Vals nga Chaplin

Nancy Kume – Poloneze nga Chopin

Ardit Abdyli - Improvizo nga Schubert & Pjesë nga Chaplin

Pjesëmarrës: Deri 50 persona.



E hënë, më datë 24 shkurt 2014

Orkestra e Harqeve e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA u bë pjesë e festimeve përmes performancës në mbrëmjen artistike të organizuar me rastin e 15-vjetorit të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, në Hotel Sheraton, ku interpretuan dhe artistë të njohur si: Josif Gjipali tenor, Eno Peci balerin, Fatos Qerimaj clarinet nën drejtimin e dirigjentit, Ermir Dizdari, Mjeshtër i madh. Në repertorin e luajtur për këtë rast ishin pjesë të kompozitorëve të njohur, ndër të cilët Bach, Mozart, Shtraus, etj.



E enjte, 27 shkurt 2014, ora 10:00

Një grup të rinjsh nga “Kultura dhe Komuniteti” u mbledhën në sallën e Klubit të Artit e Kulturës të Sigal-Durrës, në datën 27 shkurt. Në këtë takim u prezantua programi i aktiviteteve të ardhshme të “Kultura dhe Komuniteti” dhe, si gjithmonë, u fol për Kartën e Tokës dhe u bë një prezantim në Poëer Point i saj. Në takim u diskutua për mënyrën se si Karta e Tokës shërben si guidë për gjithë aktivitetin e kësaj organizate. Së shpejti, vullnetarët e saj do të fillojnë promovimin e këtij dokumenti frymëzues në shkollat e qytetit dhe më gjerë. Gjithashtu, në këtë takim u përcaktua edhe argumenti i diskutimit për takimin e ardhshëm, që është njëri nga parimet e Kartës së Tokës.



E martë, 04 mars 2014, ora 17:00



Pertef Zgjanolli

"Katorrët magjike" dhe MATEMATIKA
-10; -9; -8; ...; 2; ...; 12; 13; 14.

PËRURIM LIBRI

Durrës, Mars 2014

KLUBI I ARTIT DHE KULTURËS

SIGAL
UNICA GROUP AUSTRIA

KLUBI I ARTIT DHE KULTURËS

KLUBI I ARTIT DHE KULTURËS SIGAL
Llogja S. K. "Krisoforidhi", Nr. 1076, Durrës
Tel: (+355) 52 237 754, Cel: 0694068262
E-mail: klubarti@sigal.com.al

Lojnat dhe ushtrimet matematikore gjithmonë zgjojnë interes për nxënësit e shkollave 9-vjecare të qytetit tonë. Në këtë kuadër ishte edhe takimi me mësuesin e njohur të matematikës Peref Zgjanolli, autor i disa librave me përmbajtje metodike mësimore dhe zbavitëse dhe së fundi autor i librit "Katorrët magjike"


Pjesëmarrja
60 persona

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
ka kënaqësinë t'ju ftojë në përurimin e librit

"Katorrët magjike" dhe MATEMATIKA
e Peref Zgjanolli

Ditën e martë 04.03.2014, ora 17:00



Pertef Zgjanolli

Botimi i këtyre librave bazohet kryesisht mbi eksperiencën e gjatë të punës, thajse 36 vjeçare, si mësues i matematikës, si kryetar i komisionit metodik të matematikës, si drejtues i konkurseve të "matematikë-fizikës" ndërmjet shkollave 8-vjeçare të qytetit, të organizuara nga QKR. Duke parë nga përmbajtja e tyre librat e Zgjanollit ndahen në 3 ftoje:

1. Me përmbajtje metodike-mësimore dhe zbavitëse;
2. Me përmbajtje metodike-mësimore;
3. Me përmbajtje zbavitëse.

Është e rasti të thuhet se një pjesë nga këto botime, kryesisht materiale, që lidheshin me aktivitetet "Mbasditë matematike" ishin depozituar pranë "Shërbimit Botuesit e Librit Shkollor", në vitet 1980 dhe 1981, ku ndonëse kishte miratim për botim (me kusht të disa përmirësimeve), për arsye të botimeve të pakta të librave të këtij lloji, ato nuk u botuan në atë kohë.

Duhet theksuar se botimi i këtyre librave u mundësua nga ndihmesa dhe sponsorizimet pjesore, shumë të çmuara, të institucioneve shtetërore dhe firmave o agjensive private, si dhe të ish-mësuesve dhe prindërve të ndëruar, po kështu dhe të shumë shokëve dhe miqve, dashamirës dhe kolegëve të punës time krijuese, të cilët ishin respektiv dhe konsideratibël trimë dhe ju uroj suksese në aktivitetin e tyre.

Ka marrë t'shujt "Mik i Rimjësve" nga Drejtoria Arsimore Rajonale dhe "Mirënjohje" nga Bashkia Durrës dhe Drejtoria Arsimore Rajonale.

E mërkurë, datë 12 mars 2014, ora 15:00

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kluturës SIGAL
në bashkëpunim me
Shtëpinë Botuese OMSCA-1
kanë kënaqësinë t'ju ftojne në
aktivitetin letrarë
me temë:

**"TAKIM ME SHKRIMTARIN
LEONARD VEIZI"**

Ditën e mërkurë, 12.03.2013, ora 15:00

AKTIVITETI LETRAR

TË FTUAR:
Shtëpia Botuese Omsca, Biblioteka Publike Durrës, Klubi i Artistëve "Epoka e Talentit", përfaqësues të Bashkisë së qytetit, autori Leonard Veizi, botuesi Luan Pengili, gazetar i RTSH, shkrimtari Kliton Nasturi, poetja dhe studiuesja Flora Dervishi Gjondedaj, shkrimtari e dramaturgu Bashkim Hoxha, poeti Vaso Papa, poetja Merita Thartori, specialiste e Bibliotekës Publike Durrës, Teuta Dhima, drejtuesha e gjimnazit "Oli Lasku", Teuta Canaj dhe stafi i saj, Aiket Aliu gazetar, Aiketa Aliu mësuese, fituesit e Konkursit Letrar të Unionit të Artistëve "Pa Kufij" Armand Omeni, Ruzhdi Gole, Marisa Kerbisaj, Brikena Furxhi dhe dashamirët të letërsisë.

QËLLIMI:
Shkas nga botimi i fundit i autorit i romanit "ORGJI NE FAMULLINE E AT LUDOVIKUT"

DISKUTIMI KRYESOR
Mimoza Erubara me purimin "Vështrim krahasues në veprën e Leonard Veizit"

DISKUTIME
Flora Dervishi Gjondedaj
Vaso Papa

REFERIME TË NXËNËSVE
Jurgin Behri
Ndue Përkolaj
Bora Selencia

Pyetje të lira nga pjesëmarrësit drejtuar autorit dhe të ftuarve.

OMSCA - 1

Shtëpia Botuese OMSCA-1, e cila e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1997, është nga shtëpitë botuese më të mira dhe më të vlerësuarat të vendit tonë. Ajo dallohet veçanërisht për seriozitetin e punës, që pasqyrohet më së miri në botimet e saj cilësore, e cila bëhet e mundur nga përkushtimi i stafit të saj profesional, i gjithi mbi 18 - vjeçar.

**AKTIVITET
LETRAR**

SIGAL
UNION GROUP AUSTRIA

Klubi i Artit & Kulturës

Durrës, Mars 2014





Klubi i Artit & Kulturës
Lagja 3, Rr. "Krisoforidhi", Nr. 1074, Durrës
Tel: (0355) 212 719, Cel: 0694628842
E-mail: klubart@sigal.com.al



Me rastin e botimit të librit "ORGJI NE FAMULLINE E AT LUDOVIKUT", të autorit Leonard Veizi, u organizua një aktivitet letrar, ku ishin të ftuar shtëpia botuese "Omsca", Biblioteka Publike Durrës, Klubi i Artistëve "Epoka e Talentit", përfaqësues të bashkisë së qytetit, autori Leonard Veizi, botuesi Luan Pengili e shumë shkrimtarë e artistë të tjerë. Takimi u fokusua mbi vlerat artistike që bart ky libër dhe problematikat që shtron ai. Përveç shkrimtarëve risi ishte pjesëmarrja active e nxënësve të ftuar me diskutime dhe recitime.

Pjesëmarrës: Rreth 30 persona

E mërkurë, datë 19.03.2014, ora 18:00

	 <p><i>Klubi i Artit & Kulturës</i></p>	 <p>ARTEMISA I DURRËSIT</p>	<p>Z./Znj. _____</p> <p>Klubi i Artit dhe Kluturës SIGAL kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në eventin:</p> <p>“ARTEMISA NË DYRRRAH”</p> <p>Nga : - Profesor ARTHUR MULLER - Profesor FATOS TARTARI</p> <p>Ditën e mërkurë, 19.03.2013, ora 18:00</p>	<p>1: LEKTORIUM Ofrandat e Artemisionit në kodrat e Dautës – Durrës (gërmime të viteve 1970-1971); Rezultate të misionit Shqiptaro – Francez 2002 – 2013 në kuadrin e një projekti ndërkombëtar të kooperimit shkencor (PICS 5285) me pjesëmarrjen: - EFA (Shkollia Franceze e Athinës); - HALMA-IPEL-UMR 8164 (CNRS, LILLE 3, MCC) - Qendra Kërkimore Albanologjike (Instituti Arkeologjik i Republikës së Shqipërisë)</p> <p>2. PREZANTIMI I SERISE FILATELIKE “ARTEMISIONI I DYRRHACIONIT”</p> <p>3. ARTEMISI I DURRËSIT (Imazhe të realizuara në baltë të pjekur nga artizanët e lashtë dyrrahas)</p> <p>4: Botime kushtuar Artemisit të Durrësit</p>
<p><i>Klubi i Artit & Kulturës</i></p> <p>Lagja 1, Rr. “Kolesfordit”, Nr. 1074, Durrës Tel: (+355) 02 232 736, Cel: 069468962 E-mail: klubart@sigal.com.al</p>		<p>Durrës, Mars 2014</p>		



Vlerat muzeale dhe antike të Durrësit 3000 vjecar, gjithmonë i kanë joshur studiuesit dhe arkeologët nga e gjithë bota. Kjo është arsyeja që në sallën e Klubit Sigal Prof. Artur Muler dhe Prof. Fatos Tartari prezantuan disa rezultatet e gërmimeve të tyre.

1. Ofrandat e Artemisionit në kodrat e Dautës – Durrës (gërmime të viteve 1970-1971);
2. Rezultate të misionit Shqiptaro – Francez 2002 – 2013 në kuadrin e një projekti ndërkombëtar të kooperimit shkencor (PICS 5285) me pjesëmarrjen:
3. Prezantimi i serise filatelike “artemisioni i dyrrhacionit”;
4. Artemisi i durrësit;
5. Botime kushtuar Artemisit të Durrësit

E premte, datë 21.03.2014, ora 18:00

SIGAL
UNION GROUP AUSTRIA

FITESË

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në:

**KONCERTIN
INSTRUMENTAL**

të përgatitur nga
Nevila Kalaja

Ditën e premte, 21.03.2013, ora 18:00

Durrës, Mars 2014

Klubi i Artit & Kulturës

Programi

Bethoven, Aria Mozart, Andantino Sefrid Kapllani	VIOLINË Schuman, Fuhtari i gjuar Tedi Hatellari
Tomia dhe shokët e tij Melodi Isl Nuredini	Brahms, Vela Viola Gashi
E. Carulli, Vela e varacion nr.1 Pavli Pantar Tedi Kallço	Tema e filmi "Irrugë të Bardha" Nino Tereziu
J. Kufner, Andantino Serenadë Ejona Limanaj	Kompanila Geti Çarla
F. Carulli, Vela nr.2 Lefin dance Isl Merninaj	D. Novacek, Motto-Perpetuo Kledi Maneci
Melodier, Afetuosco Tango, 2 Mitarrat Josina Laci	P. Gace, Pjesë Krisi Maneci
G. Aguado, Allegretto Valsetto Elina Vilde	Bachi, Gavotë Selma Luku
Melodi, Bossanova Marilaci Krisi Qerama	PIANO Paganini, Karnavalet e Venecias Sara Doka
Spantah Dance Rosaileta Amela Gjoni	

Klubi i Artit & Kulturës SIGAL
Lagja 3, Rr. "Niketaforidhi", No. 1074, Durrës
Tel: (+355) 52 237 704, Cel: 0694068962
E-mail: klubart@sigal.com.al




Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL organizoi një concert me nxënës instrumentiste të përgatitur nga mësuesia e violinës Nevila Kalaja dhe mësuesi i kitarës Edi Tereziu. Ata luajtën pjesë nga Bethoven, Moxarti, Novaveç etj. Nxënësit Sefrid Kapllani, Isl Nuredini, Tedi Kallço, Ejona Limanaj ishin vetëm një pjesë e shumë artistëve që interpretuan me sukses pjesët e tyre në këtë concert.

Pjesëmarrës: 30 fëmijë të moshës 11-17 vjeç

E enjte, datë 27.03.2014, ora 18:00

Takimi i radhës me të rinjtë e “Kultura dhe Komuniteti”

Përsëri në ambientin e “Klubit të Artit, SIGAL UNIQA”, të rinj nga “Kultura dhe Komuniteti” u mblodhën në aktivitetin e tyre të radhës. Argumenti kryesor i takimit ishte trajtimi i temës së shpallur, në takimin paraardhës, parimi i parë i Kartës së Tokës.

Për këtë qëllim u organizua edhe një ëorkshop i vogël dhe, në frymën e këtyre diskutimeve aktive nga të rinjtë u realizua një ndërgjegjësim më i mirë lidhur me problemin e dinjitetit të lindur të njeriut dhe të ndërvarësisë së gjithë qenieve që përbëjnë komunitetin e jetës.

Në takim u lanë detyrat për aktivitetet e K&K, në vazhdim...



E shtunë, 5 prill 2014, ora 11:00

Klubi i Artit dhe Kulturës Sigal u bë përsëri vendi ku u organizua Konferenca Ndërminstrore e Fëmijëve, me anëtarët e “Zërit 16+...Durrës” që mbështeten nga “Save the Children. Qëllimi i konferencës ishte të merret informacion lidhur mbi çështjet që shqetësojnë fëmijet e qytetit të Durrësit, që do të shërbejnë si një bazë për të kryer studimin dhe raportin alternativ mbi zbatimin e KDF.

Pjesëmarrës: 20 persona



E enjte, 10 prill 2014, ora 18:00

N CPP Albania

Programi Kombëtar për Prodhimin më të Pastër në Shqipëri
Seminar Informues

Përdorimi i Efektshëm i Burimeve për Prodhim më të Pastër (RECP) si dhe Përgjegjësia Sociale (CSR) për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Shqipëri
Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL, Durrës

Datë 10 Prill 2014, ora 10:00

Programi

09:30-10:00 - Regjistrimi dhe kafe

10:00-10:10 - Fjala Përshëndetëse – Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit

11.35-11.55 - Industria e Turizmit dhe rëndësia e standarteve të cilësisë në shërbimet turistike – Matilda Naço Andoni, ATA, Drejtore Ekzekutive, Shoqata Shqiptare e Turizmit

10.15-10.40 - Rezultatet e PEBPP-së në Shqipëri dhe prezantimi i projektit të UNIDO për vendet e Europës Juglindore në zbatimin e RECP&CSR – Marieta Mima, Drejtore e Programit Kombëtar për Prodhim më të Pastër.

10.45-11.05 – Histori Suksesi nga Programi Kombëtar për Prodhim më të Pastër në sektorin e hotelerisë – Franka Paloka, Drejtore Ekzekutive, Qendra për Zhvillim të Integruar dhe konsulente për Turizmin dhe planifikimin.

11.10-11.30 – Përgjegjësia Sociale e kompanive në sektorin e Turizmit. – Jorina Kadare, Menaxhere e Projektit të Përgjegjësisë Sociale në sektrin e Turizmit.

12.00-12.20 – Përgjegjësia Sociale versus Zhvillim i Qëndrueshëm i Turizmit. – Delina Nano, Drejtore, Instituti për Promovim Social Ekonomik (IPSED) dhe konsulente pranë bashkimit të dhomave të tregtisë.

12:20-12:30 – Diskutime

12.30-14.00 - Dreka



E premte, 11 prill 2014, ora 18:00

Kultura dhe Komuniteti organizoi, në bashkëpunim me DAR, Durrës, një konkurs të fotografisë, të frymëzuar nga Karta e Tokës, me temë: “Toka, Shtëpia jonë e përbashkët”. Fituesit e këtij konkursi do të shpallen gjatë një ceremonie festive, në datën 22 Prill, që është edhe Dita Ndërkombëtare e Tokës. Takimi me të rinjtë që marrin pjesë në këtë konkurs, gjatë prezantimit të projektit dhe dhënies së orientimeve përkatëse, u zhvillua në ambientin e Klubit të Artit –Sigal, Durrës.

Pjesëmarrës: Mbi 20 persona

*Je i lodhur
nga radhët e gjata
nëpër spitale?*

*Siguro shëndetin, merr
shërbimin më të mirë
mjekësor brenda dhe
jashtë vendit!*

*Vetëm në SIGAL UNIQA
Group AUSTRIA!*



E shtunë, 22 prill 2014, ora 11:00


Në vazhden e veprimtarive të shumta të “Zërit 16+.... U bë dhe hartimi i pyetësorit për konferencën ndërministrrore të fëmijëve, anëtarë të “Zërit 16+...Durrës” që mbështeten nga “Save the Children”.

Me këtë rast u zhvillua një ëorkshop “Peer to Peer” ku u diskutua dhe u ndanë eksperiencia, duke treguar hapat se si ishin realizuar pyetjet e pyetësorit. U shpërndanë për tu plotësuar sipas një kampionimi të përcaktuar 150 pyetësorë në 4 shkolla (dy 9-vjeçare dhe dy të mesme).

Pjesëmarrës: 20 fëmijë të moshës 11-17 vjeç



E enjte, 24 prill 2014, ora 18:30

 <p><i>Klubi i Artit & Kulturës</i></p>	<p style="text-align: center;">Ftesë</p> <p>Znj. _____</p> <p>Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL, ne ambjentet e tij, ka kenaqesne t'ju ftoje ne festen e pervitshme me dramatizimet e femijeve te qendres se gjuhes angleze "WISDOM" DURRES</p> <p>Diten e Enjte , date 24 Prill 2014, ora 18:30</p>	<p style="text-align: center;">Program:</p> <p>Grupi I Fairyland 3 Pjesa : " At the toyshop" Mesuesja : Adela Allaj</p> <p>Grupi II Fairyland 3 Pjesa : " The old house" Mesuesja : Adela Allaj</p> <p>Grupi III Fairyland 4 Pjesa : " Meet XL" Mesuesja : Irma Kashari</p> <p>Grupi IV Fairyland 4 Pjesa : "The magic mirror" Mesuesja : Irma Kashari</p> <p>Grupi V Fairyland 4 Pjesa : "The animal Elections" Mesuesja : Irma Kashari</p> <p style="text-align: center;">QENDRA E GJUHES ANGLEZE "WISDOM" DURRES</p> <p><i>Me rastin e 12 Vjetorit te hapjes se shkolles, organizon programin e pervitshem te dramatizimeve te femijeve ne gjuhen angleze.</i></p> <p><i>E hapur ne Prill te vitit 2002,qendra ka patur dhe vazhdon te kete nje rritje te vazhdueshme , ne nivel dhe cilesi. Eksperience ne te gjitha nivelet e anglishtes te ndara ne klasa sipas moshave dhe niveleve. Klasat jane te pajisura me teknologjine me te fundit, perfshire ketu video projektor, kompjuter duke realizuar keshtu mesim interaktiv.</i></p> <p><i>Metodat e fundit te mesimdhënies kane pasqyruar çdo vit pjesemarrje te rzenesve tane ne provime nderkombetare me rezultate te larta,gje qe ka motivuar ne vazhdimesi mesuesit dhe studentet prane qendres tone.</i></p>
	<p style="text-align: center;">Durrës, Prill 2014</p>	<p><i>Klubi i Artit & Kulturës</i> </p> <p>Rruga, "Tregtare", Durrës Cel: 0694068672, 0692148125</p> 



Qendra e Gjuhës Angleze me rastin e 12 vjetorit të hapjes së saj organizon në sallën e Klubit të Artit dhe Kultures Sigal programin e përvitëshëm të dramatizimit të fëmijëve në gjuhën angleze.

E hënë, 28 prill 2014, ora 11:00

Sërish me promovimin e Kartës së Tokës:

Në këtë aktivitet argumenti qendror i takimit ka qenë:

Kujdesi për komunitetin e jetës me mirëkuptim, dhembshuri dhe dashuri:

a. Të pranojmë që, bashkë me të drejtën për zotërimin, menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, vjen edhe detyra për të parandaluar rrezikun mjedisor dhe për të mbrojtur të drejtat e njerëzve.

b. Të pohojmë që me lirinë, njohjen dhe fuqinë në rritje vjen dhe përgjegjësia në rritje për të promovuar të mirën e përbashkët.

Të rinjtë që morën pjesë në këtë takim ishin mjaft aktivë dhe ndanë me njëri-tjetrin vizionin për të ardhmen dhe idea konkrete bashkëpunimi për të dhënë kontributin e tyre.



E mërkurë, 30 prill 2014, ora 18:30

Thimi Çollaku



Lindur në Hochtsh të Devollit, në vitin 1935. Shkolën shtetërore a mbaroi në Tiranë, gjimnazin në Shkodër dhe u diplomua në Institutin për Marrëdhënie Nderkombëtare në Moskë. Pese vjejt punoi si referent në Komitetin për Marrëdhënie Kulturorë e Mbrojtore me Botën e Jashtme dhe dhjetra vjejt në Redaksinë e Informacionit në Radio Tiranë; 1975-1979. Punon matorist, torritor në Oficinë e Automjeteve të Nderimitit në Tiranë dhe më pas ftonderit në Fonderinë e Kombinattit të bektstëve Berat. 1979 - 1989 Punon në Bibliotekën "Kahraman Ylli", Berat. 1989-1991, mësues në Kozarë të Beratit. 1992, kthihet në Tiranë dhe punon në Bibliotekën Kombëtare. 1993, emërohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme, drejtor i Institutit për marrëdhënie Nderkombëtare. Më pas, vazhdot punën si specialist, në bibliotekën dhe Arkivin e Ministrisë derisa doli pension në vitin 1997. Ka shkruar një mori artikujsh dhe analizash për ngjarjet ndërkombëtare. Ka përgatitur për Radio Televizionin Shqiptar shume cikle bisedash për ikonografine dhe kodifiket shqiptare, për veprimtarine dhe figurat e spikatura të diasporës shqiptare, për shkrimtarët e huaj dhe veprat e tyre të sjella në shoqë nga perktthyesit tana. Për veprimin "Pjetëja dhe përgjigje për Shqipërinë", botuar në vitin 1969 vetem në gjuhët anglisht, hëngjisht dhe spanylisht (pa asnje emër, autori meritoi Urdrhin "Naim Frashëri KL II".

Eshte bashkautor i vëllimit "Manuali diplomatik i Republikës së Shqipërisë; autor i "Kalendari i Botës Shqiptare", "Sherbimi Konsullor në trojet shqiptare", "Shqipteria pale në Traktatat Nderkombëtare".



Klubi i Artit & Kulturës



Promovim i librit "Një Zë nga Fillesa"
të autorit Thimi Çollaku,
kushtuar artistit Mihal Ciko.

Durrës, Prill 2014

Klubi i Artit & Kulturës
Lagja 3, Rr. "Ndesatortit", Nr. 1074, Durrës
Tel: (+355) 52 232 704, Cel: 069640622
E-mail: klubart@sigal.com.al



Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL organizoi në ambjentet e tij promovimin e librit "Një Zë nga Fillesa", të autorit Thimi Çollaku, kushtuar artistit Mihal Ciko. Veprimtaria u shoqërua me koncert dhe një pritje koktejl.

Pjesëmarrës: 30 persona

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
organizon në ambjentet e tij promovimin e librit "Një Zë nga Fillesa" e autorit Thimi Çollaku, kushtuar artistit Mihal Ciko.

Veprimtaria shoqërohet me një koncert dhe pritje koktejl.

Ditën e mërkurë 30/04/2014, ora 18:30



Mihal Ciko në veprimtari të ndryshme.



E shtunë, datë 3 maj 2014, ora 11:00

Anëtarët e “Zërit 16+...Durrës” që mbështeten nga “Save the Children” në një nga veprimtarit e tyre të radhës ishte dhe diskutimi i draft-raportit paraprak për studimin e pyetësorëve dhe hartimi i raportit për konferencën ndërministrrore. Qëllimi i konferencës ishte që fëmijët të paraqesnin probleme për zgjidhjen e të cilave kërkohet ndihma dhe ndërhyrja e qeverisë. Pas hartimit të raportit nga specialistët, anëtarët e CLG Durrës diskutuan rreth gjetjeve kryesore që vërtetë janë shqetësuese dhe kërkojnë zgjidhje e ndihmë nga organet e pushtetit vendor e lokal. Pas hartimit të raportit përfundimtar, fëmijët hartuan dhe rekomandimet përkatëse.

Pjesëmarrës: 30 fëmijë të moshës 11-17 vjeç



E shtunë, datë 10 maj 2014, ora 11:00

Të dëgjosh mendimet dhe zërat e fëmijve tanë.

Anëtarët e “Zërit 16+...Durrës” që mbështeten nga “ Save the Children”. Video-mesazhe të fëmijëve për respektimin e të drejtave të fëmijëve. Ata kishin përgatitur materiale sensibilizuese për mbrojtjen e kauzës së tyre.

Pjesëmarrës: 20 persona



E martë, datë 13 maj 2014, ora 11:00

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile & Shoqata e Grave me Probleme Sociale

Shoqata e Grave me Probleme Sociale, në kuadër të zbatimit të projektit “Të rinjtë e disavantazhuar të zonave periferike, kandidatë të resë në tregun e punës”, financuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi në ambientet e Klubit SIGAL seminarin me temë: “Tipologjia në tregun local të punës, promovimi i shprehive profesionale e personale të të rinjve përfitues të projektit”.

Ky seminar u zhvillua në kuadër të përmbylljes së projektit. Qëllimi i këtij seminari ishte identifikimi i nevojave të tregut, prezantimi i arritjeve të projektit dhe mbi të gjitha promovimi i shprehive profesionale dhe personale të fituara nga të rinjtë përfitues.

Pjesa e dytë e seminarit morri trajtat e një panairi pune, ku bizneset patën mundësi që të intervistojnë të rinjtë përfitues të projektit për të vlerësuar mundësitë e punësimit të tyre pranë bizneseve që ata ndërtojnë.

Ky aktivitet u organizua me ndihmesën e Znjsh. Esmeralda Shkjau, Deputete e Qarkut të Durrësit në Parlamentin e Shqipërisë, Bashkisë Durrës si dhe Zyra e Punësimit Durrës.



E shtunë, datë 17 maj 2014, ora 11:00

Me datë 17.05.2014 zhvillohet

FESTIVALI I POEZISË

"Pramvera Poetike Durrsake"

Ftohemi të ndermi pjesë.

PROGRAMI

1. Hapja e festivalet, ora 11:00
në Teatrin A. Mina, odoe në Shtetë Utoje,
nga Kryetari i Klubit Nënë e Spahiu.

2. Akademici e poezitë
- Fikret Dën
Reçitua Aletë Stani
Reçitua Agim Bajrami
Reçitua Habi Hoxha
Reçitua Albina Idrizi
Reçitua Adnanaj da Dajko
Reçitua Pasholë Kaci
Reçitua Habi Hoxha
Reçitua Vasilinë Maja
Reçitua Adnanaj da Dajko
Reçitua Shëderi Tetaj
Reçitua Habi Hoxha
Reçitua Bardhyl Agui

3. Vënie në shprehje meze në Aleksander Moisiu,
ora 12:30

4. Dëto, ora 13:30

5. Ora poetike, ora 17:00
në bashkëpunim me Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL

6. Darkë, ora 20:00

SIGAL
UNIQA GROUP AUSTRIA

KLUBI I SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE
DURRES

FTESË

SPONSOR:


SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
TEUTA Durres
Firma e ndërtimit A.G.Z.A

Klubi i Artit & Kulturës

Z./Znj. _____

Durres, Maj 2014

Klubi i Artit & Kulturës
Lagja 3, Nr. "Komboridit", Nr. 1074, Durres
Tel: (+355) 03 237 704, Cell: 099460842
E-mail: klubart@sigal.com.al




E mërkurë, datë 21 maj 2014, ora 11:00

FTESE

Z./Znj. _____


Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
kanë kënaqësinë t'ju ftojë në ambjentet e tij në:

Promovimin e librit me poezi
"Bukë e Hidhur"
e Viktoria Xhako

Ditën e mërkurë, 21.05.2014, ora 18.00

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL organizoi një event interesant me rastin e promovimit të librit të shkrimtares durrsake Viktoria Xhako. Miq të autores dhe dashamirës të letërsisë e në veçanti të poezive të poetes Xhako ishin të pranishëm me diskutime, recitime dhe mendime rreth vlerave që mbart poezia e saj.

Pjesëmarrja: 20 persona



VIKTORIA XHAKO

SIGAL
UNICA GROUP AUSTRIA

BUKË E HIDHUR

POEZI

Klubi i Artit & Kulturës

Durrës, Maj 2014

 The book cover for 'Bukë e Hidhur' by Viktoria Xhako. It features a dark background with several bright yellow flowers. The title 'BUKË E HIDHUR' is written in large, bold, white letters. Above it, the author's name 'VIKTORIA XHAKO' is printed. The publisher's logo 'SIGAL UNICA GROUP AUSTRIA' is in the top left corner. The text 'Klubi i Artit & Kulturës' is written vertically on the left side, and 'Durrës, Maj 2014' is at the bottom.

Datë 22 Maj 2014, ora 09:00



FTESË

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
organizon në ambjentet e tij:

Workshop
Diversiteti dhe trashëgimia kulturore
përgatitur nga:
Ermira Peku Zhiti, Nije Farruku, Mimoza Agolli

Dita e parë, e enjte 22 maj 2014, ora 09:00

- Fokus grup me nxenes te Senatit te shkollave "Neim Babameto" dhe "Qemal Mici".
- Prezantime me p.point/Projekti Diversiteti kulturor dhe Trashëgimia kulturore (Punoi Ermira Zhiti).
 - Prezantime me p.point/Kenget dhe vallet e tradites. (pergatitur nga Silvana Pica).
 - Ekspozite me punime te vete nxënësve nga trashëgimia kulturore.
 - Bisede rreth vlerave, pune ne grupe, diskutime dhe prezantime nga krijime te vete nxënësve.

Dita e dytë, e premte 23 maj 2014, ora 18:30

- Sfilate e shoqruar me prezantim ne power point mbi trashëgimine kulturore shpirtore nga vete nxenesit.
- Pjese nga folklori.

Projekt: Diversiteti dhe Trashëgimia Kulturore

Qëllimi: Njohja, ruajtja, zhvillimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore nëpërmjet procesit të edukimit.

Kjo iniciativë synon ndërgjegjësimin e të rinjve që trashëgimia kulturore përbën jo vetëm një të mirë publike, por edhe një dtyrë sa individuale aq edhe kolektive për ruajtjen e saj.

Misioni: Rritja e ndjeshmërisë së shoqërisë kundrejt vlerave të trashëgimisë kulturore, përmes edukimit. Zhvillimi i trashëgimisë kulturore bëhet që kjo pasuri t'u ngelet brezave në të ardhmen.

Dita I: Fokus-grup me nxënës të senatit të shkollave "Neim Babameto" dhe "Qemal Mici"; Prezantime me P.Point, projekti: Diversiteti Kulturor dhe Trashëgimia Kulturore (Punoi: Ermira Zhiti)

Prezantime me P.Point: Këngët dhe vallet e traditës (Përgatiti:Silvana Pica)

Ekspozitë me punime të vetë nxënësve dhe trashëgimia kulturore.

Bisedë rreth vlerave, punë në grupe, diskutime dhe prezantime nga krijime të vetë nxënësve.

Përgatitën:

Ermira Peku Zhiti, Nije Farruku, Mimoza Agolli



E premte, 23 Maj 2014, ora 18:30




Klubi i Artit & Kulturës

**DIVERSITETI
DHE
TRASHËGIMIA KULTURORE**

Burrës, Maj 2014

Projekt: Diversiteti dhe Trashëgimia Kulturore

Qëllimi: Njohja, ruajtja, zhvillimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore nëoërmjet procesit të edukimit. Kjo iniciativë synon ndërgjegjësimin e të rinjve që trashëgimia kulturore përbën jo vetëm një të mirë publike, por edhe një dtyrë sa individuale aq edhe kolektive për ruajtjen e saj.

Misioni: Rritja e ndjeshmërisë së shoqërisë kundrejt vlerave të trashëgimisë kulturore, përmes edukimit. Zhvillimi i trashëgimisë kulturore bëhet që kjo pasuri t'u ngelet brezave në të ardhmen.

Dita II: Sfilatë e shoqëruar me prezantim në P.Point mbi trashëgiminë kulturore shpirtërore nga vetë nxënësit. Pjesë nga folklori.

Përgatitën:

Ermira Peku Zhiti

Nije Farruku

Mimoza Agolli



FTESË

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
organizon në ambjentet e tij:

Workshop
Diversiteti dhe trashëgimia kulturore
përgatitur nga:
Ermira Peku Zhiti, Nije Farruku, Mimoza Agolli

Dita e parë, e enjte 22 maj 2014, ora 09:00

- Fokus grup me nxenes te Senatit te shkollave "Neim Babameto" dhe "Qemal Mici".
- Prezantime me p.point/Projekti Diversiteti kulturor dhe Trashëgimia kulturore (Punoit Ermira Zhiti).
 - Prezantime me p.point/Kenget dhe vallet e tradites. (pergatitur nga Silvana Pica).
 - Ekspozite me punime te vete nxënësve nga trashëgimia kulturore.
 - Bisede rreth vlerave ,pune ne grupe,diskutime dhe prezantime nga krijime te vete nxënësve.

Dita e dytë, e premte 23 maj 2014, ora 18:30

- Sfilate e shoqeruar me prezantim ne power point mbi trashëgimine kulturore shpirtërore nga vete nxenesit.
- Pjese nga folklori.

E shtunë, 24 maj 2014, ora 11:00

Anëtarët e “Zërit 16+...Durrës” që mbështeten nga “ Save the Children”.

Një tjetër aktivitet ndërgjegjësues dhe argëtues në lidhje me festën e fëmijëve për 1 qershor, ku “Save the Children” në bashkëpunim me “Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, eorld Vision, UNICEF, BKTF dhe Terre des Homes. Nga CLG Durrës u përgatitën 3 video-mesazhe, ku vetë ata ishin personazhe të videove. Nëpërmjet këtyre filmime ata kërkonin që në familje e në shkollë të kishin të drejtën e vendimmarrjes si dhe të drejtën e grumbullimit dhe të protestës paqësore si një një zë më shumë për të drejtat e tyre.

Pjesëmarrës: 30 fëmijë të moshës 11-17 vjeç



E dielë, 1 qershor 2014, ora 11:00

Përgjatë disa muajve, ambientet e Klubit të Artit Sigal në Durrës u transformuan në studio radioje, falë Radio Green Albania, ku shumë të rinjtë mundën të realizonin intervistat, të kryenin procesin e montimit dhe të mblidheshin së bashku për të diskutuar për emisionet e larmishme në formatin digital në adresën: www.radiogreenalbania.org.

Aktivitetet e shumta në ambientet e Klubit të Artit Sigal, bënë që edhe profili i intervistave të tyre në këto muaj të ishte i larmishëm.

Radio Green Albania lindi në sajë të projektit: “Preserve and enhance sustainable tourism in Lalzi Bay and Berat” realizuar nga Iscos Lombardia me financimin e CEPF (Critical Ecosystem Partnership Fund). Objektivi i tij është sensibilizimi i qytetarëve dhe institucioneve lokale mbi turizmin e qëndrueshëm.

Pjesëmarrja: 20 persona



E mërkurë, 4 qershor 2014, ora 18:30

LEADER SIGAL
 President: **Edmond Haxhiu**
 Vice President: **Edmond Haxhiu**
 Secretary: **Edmond Haxhiu**
 Treasurer: **Edmond Haxhiu**
 Member: **Edmond Haxhiu**

MEMBERSHIP LIST
 1. **Edmond Haxhiu**
 2. **Edmond Haxhiu**
 3. **Edmond Haxhiu**
 4. **Edmond Haxhiu**
 5. **Edmond Haxhiu**
 6. **Edmond Haxhiu**
 7. **Edmond Haxhiu**
 8. **Edmond Haxhiu**
 9. **Edmond Haxhiu**
 10. **Edmond Haxhiu**




Klubi i Artit & Kulturës

Ekspozitë pikturë

Shkup, Qershor 2014

Z./Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL
 organizon në ambjentet e tij
 ekspozitën
 e
 pikurave ekstravogant
Mr. LEONARDO VOCI

Data e mëkësaj, datë 04-06/2014, ora 18:30



Mr. LEONARDO VOCI
Pjesë e Kulturës

Mr. Leonardo Voci is a member of the SIGAL Club of Art and Culture. He is a professional painter and a member of the SIGAL Club of Art and Culture. He has participated in several exhibitions and has received awards for his work.

PROJEKTI I EKSPONIMIT

1. **Portrait of a woman**
 2. **Portrait of a man**
 3. **Portrait of a child**
 4. **Portrait of a woman**
 5. **Portrait of a man**
 6. **Portrait of a child**
 7. **Portrait of a woman**
 8. **Portrait of a man**
 9. **Portrait of a child**
 10. **Portrait of a woman**



E shtunë, 14 qershor 2014, ora 18:30

U zhvillua ceremonia e ndarjes së cmimeve të konkursit të letërsisë dhe pikturës, të shpallur nga Unioni i Artistëve Pa Kufi, si pjesë e Akademisë Europiane të ARTIT, me një pjesëmarrje prej 115 artistë prej të cilëve u përzgjedhën si garues 9 në prozë, 15 në poezi, 25 në pikturë dhe 3 në fotografi me një shtrirje gjeografike nga Tirana, Prishtina, Kumanova, Durrësi, Gilani, Shkodra, gramshi, Metvegja, si dhe nga Franca-Parisi, Hollanda, Alaska-USA, Beer-Sheva,-Izrael, pjesëmarrje që i dha frymëmarrje të gjërë këtij aktiviteti.

Këtë konkurs e begatoj edhe pjesëmarrja nga 6 deri 70 vjecarë.

Fjalën e rasti e majti Mimoza Erebara përfaqësuese e këtij Unioni për Seksionin Kombëtar Shqipëtar, e njëkohësisht edhe nën/Kryetare e Akademisë Europiane të Artit, për Seksionin Kombëtar Shqiptar gjithashtu përshëndeti pjesëmarrësit edhe Prof. Jetullah Haliti, piktor Kryetar i Akademisë Europiane të Artit për Seksionin Kombëtar Shqipëtar. Të gjithë pjesëmarrësit u paisën me certifikatë pjesëmarrje dhe një e tillë mirnjoje ju dha Klubit i cili mundësoj këtë veprimtari duke vënë në dispozicion mjediset e veta. Ishin të gjithashtu edhe studiues,shkrimtarë,gazetarë të cilët u përshëndetën këtë manifestim.



E martë, 17 qershor 2014, ora 18:00



Klubi i Artit & Kulturës

Ftesë

Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL,
organizon ne ambjentet e tij
koncertin permylles
të viti shkollor, me nxenes
te klases se pianos
te Shkolles se Mesme Artistike
"Jan Kukuzeli"

Pergatitur nga mesuese
Adriana Frasherit
Valbona Bihiku

Diten e Marte, date 17.06.2014, ora 18⁰⁰

Durrës, Qershor 2014

Programi:

T. Daija - "Zocia dhe macoku"
I. Berliovic - Variacione
H. Zacharian - "Kenga dhe loja"
Interpreton: Isabel Bozo, kl.I

Tompson - Baillando il minuetto
J.S. Bach - Minuetto
Interpreton: Elvis Hushi, kl.II

W. Duncombe - Sonatina
V. Kurockin - Dolce risveglio
Interpreton: Ilva Traga, kl.II

Clementi - Sonatina
Joplin - Tradicionale amerikane
Interpreton: Luara Hidri, kl.II

Kuhlau - Sonatina
Joplin - Raggy
Interpreton: Serena Beja, kl. II

J.B.Luffy - Minuetto
Poldin - Vallja e xhuzhave
Interpreton: Sigrid Kapllari, kl. III

Beethoven - Sonatina
J. S. Bach - Minuetto
Interpreton: Xhoel Millaqi, kl. III

J. P. Kirnberger - Lullaby
Tompson - El matador
Interpreton: Gestiana Gjoni, kl. III

W.A. Mozart - Minuetto
J. S. Bach - Minuet
E. Filipp - Davanti a un praticello
Interpreton: Ester Hoxha, kl. IV

T. Harapi - Valle
D. Kabalevskij - Danca del guerriero
E. Filipp - Davanti a un praticello
Interpreton: Elisabeta Tuga, kl.IV

J. S. Bach - Minuet
D. Kabalevskij - Variacione
Interpreton: Eria Kasa, kl.IV

K. Lara - Prehud
F. Schubert - Improviso
Interpreton: Alisha Kristani, kl.VI

Glinka - Variacione
D. Kabalevskij - Prelud
Interpreton: Bekim Ballshkashi, kl. VIII

Glinka - Variacione
J. Brahms - Kaprico
Interpreton: Xhoanino Ujka, kl. VIII

Prinder te dashur!

Shpresojme te kenaqeni me punen tone dhe ju falenderojme
nga zemra per mbeshitetjen qe na keni dhene.

Tani ne vendin tone do te flasim tingujt te cilet do te jene edhe
felenderimi yne per ju!

Ju duam shume dhe ju kemi ne zemer!

Klubi i Artit & Kulturës



Lagjia 3, Rr. "Kristoforidhi", Nr. 1074, Durrës
Tel: (+355) 52 237 704, Cel: 0694068962
E-mail: klubiartit@sigal.com.al



E mërkurë, 18 qershor 2014, ora 18:00

Ftesë

Znj. _____

SIGAL
UNIONA GROUP AUSTRIA

KLUBI I ARTIT & KULTURËS

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL,
organizon ne ambjentet e tij
koncertin me violiniste te rinj
te Shkolles se Mesme Artistike
"Jan Kukuzeli"

Pergatitur nga petagogu i violines
Arben Diku
Shoqeron ne piano petagoge
Mirela Xhaferraj

Diten e Mërkure, date 18.06.2014, ora 18⁰⁰

Durrës, Qershor 2014

Program:

Moxhart - Allegro..... I. Hima

Bethoven - Lulja e bukur..... N. Deliallisi

J. Papadhimitri - Kali i vogel..... G. Kurti

Hendel - Gavot
me variacione... E. Çerent

Jashinov - Koncert..... P. Paço

Bom - Motoperpeto..... J. Shehu

N. Zaraqit - Valle..... M. Setja


Rode - Koncert..... A. Sali

Vloti - Koncert..... Xh. Byci

Paganini - Koncert ne Re,
Koha I..... R. Deda

Lalo - Koncert, koha V
Sinfonia Spanjolle.. R. Ushina

KLUBI I ARTIT & KULTURËS **SIGAL**
Lagje 3, Rr. "Krisoforidhi", Nr. 1074, Durrës
Tel: (+355) 52 237 704, Cel: 0694068962
E-mail: klubiartr@sigal.com.al



Vlera intnrepretative dhe performancë e violinistëve të rinj të shkollës së mesme “Jan Kukuzeli”



E premte, 20 qershor 2014, ora 18:00



Klubi i Artit & Kulturës

Ftesë

Znj. _____

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL,
organizon ne ambjentet e tij

Koncertin Recital

Pergatitur nga
Dirigjente, Petagoge piano
Shpresa Tafaj

Diten e Premte, date 20.06.2014, ora 18⁰⁰

Programi:

Katerina Kote :
Diabelli - Sonatina , Cabalevski (Kilouris).

Klervi Pepa:
Melodi Ruse - Melodi Ukrainase

Larisa garuli:
Kenge per femije - Due barche varno, Kenge popullore Letone.

Iva Saliliari:
Grig - Lindja e Diellit, Kenge O Susanna

Dea Semini:
Stravinski - Valsi I Killockes, Kenge ruse

Katerina Besho:
Schubert - Ave Maria, Shtraus Vals.

Luna Gjyzeli:
Bethoven - Tema nga Sinfonia e 9, Melodi (Faremo I dolci)

Ergi Konci:
Canzone Popolare Ruse, Grig (lindja e diellit)

Endrju Bozo:
Shtraus Valz, Kenge o Susanna, Valsi I Killockes.

Rei Escobar:
Stojanof Variacione , Pjese Lo Spettacolo continua.

Odi Cami:
Shopen Poloneze Balada.

Lea Kacuqi
Shopen Vals, Adaggio.

Megi Kodra:
Bethoven Per Elizen , Kenge Yesterday.

Rezarta Agasi:
Mozart Sonata, Shopen Mazurka

Alda Gjeka:
Glinika Variacione.

Durrës, Qershor 2014

Klubi i Artit & Kulturës 
Lagja 3, Rr. "Kristoforidhi", Nr. 1074, Durrës
Tel: (+355) 52 237 704, Cel: 0694068962
E-mail: klubiartit@sigal.com.al



Petagogia Shpresa Tafaj me nxënësit e saj jep një tjetër recital të suksesëshëm. Programi i pasur me vepra të kompozitorëve më të Njohur ishte një tjetër evidentim i punës së mirë që bën kjo pedagoge me talentet e reja.






E martë, 24 qershor 2014, ora 18:00

Në kuadër të një sërë aktiviteteve të anëtarëve të “Zëri 16+...Durrës”, mbi të drejtat e fëmijëve, ata organizuan një tjetër takim më datë 24 qershor, pranë ambienteve të Klubit të Artit dhe Kulturës Sigal. Të mbështetur nga organizata “Save the Children”, fëmijët e CLG Durrës kishin përgatitur një draft-raport paraprak për konferencën ndërministrnore, ku ndër të tjera ata ja dolën të parashtronin një sërë problematikash, të cilat kërkonin ndërhyrjen e qeverisë.

Pjesëmarrës: 30 fëmijë të moshës 11-17 vjeç






E hënë, 30 qershor 2014, ora 18:30

